


TaxNews

SPECIAL

Dhjetor 2018
December 2018



Në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018 është publikuar pjesa e dytë e Paketës Fiskale 2019 (pjesën e parë të Paketës Fiskale 2019 e kemi përmbledhur në Special Tax News të muajit korrik 2018). Ndryshimet kryesore që sjell kjo pjesë e dytë e Paketës Fiskale 2019 i kemi përmbledhur në disa publikime të njëpasnjëshme për lehtësi leximi. Të gjitha këto ndryshime hyjnë në fuqi më 01.01.2019 (përveç rasteve ku specifikohet ndryshe).

Ligji "Për procedurat tatimore"

Ndryshimet në këtë ligj kanë si qëllim kryesor vendosjen e rregullave të përgjithshme kundër shmangies tatimore, mundësimin e përdorimit më të gjerë të mënyrave alternative të vlerësimit tatimor si dhe reduktimin e kostove të administrimit dhe të biznesit.

● Regjistrimi i Personit Fizik Tregtar

Një Person Fizik Tregtar në kuptimin e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të regjistrohet dhe pajiset vetëm një herë me një NIPT/NUIS nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). Për çdo veprimtari të re që ai/ajo do të kërkojë të regjistrojë, do të pajiset nga QKB me një certifikatë të re me të njëjtin NIPT/NUIS, por me numër serial të ndryshëm (për të identifikuar veçmas veprimtarinë e re). Më parë, nuk kishte ndonjë kufizim të shprehur mbi numrin e Personave Fizikë Tregtarë dhe pra numrin e NIPT/NUIS-eve që i njëjti individ mund të regjistronte.

Mbajtja/regjistrimi i më shumë se një NIPT/NUIS nga i njëjti tatimpagues me status Person Fizik Tregtar dhe dorëzimi i deklaratave të veçanta për çdo NIPT/NUIS do të konsiderohet si tregues për shmangie tatimore dhe do të jetë objekt i mënyrave alternative të vlerësimit nga ana e administratës tatimore.

The second part of the Fiscal Package 2019 has been published (please find the first part of the Fiscal Package 2019 summarized in our Special Tax News of July 2018). For easier reading, we have summarized the main changes brought by this second part of the Fiscal Package 2019 in a few consecutive articles. All these changes enter into force as of 01.01.2019 (unless otherwise stated).

Law "On tax procedures"

The main objective of the changes in this law is introducing general anti-avoidance rules, enabling a broader use of the alternative methods of tax assessment and reducing administrative and business costs.

● Registration of an Entrepreneur

An Entrepreneur (Commercial Physical Person) in the meaning of the Law "On entrepreneurs and commercial companies" shall register and obtain a Tax Identification Number (NIPT/NUIS) from the National Business Center (NBC) only once. For any new activity that he/she shall seek to register, the NBC shall issue a new certificate with the same NIPT/NUIS, but with a different serial number (to separately identify the new activity). Previously, there were no specific restrictions regarding the number of Commercial Physical Persons i.e. the number of NIPT/NUIS that the same individual could register.

The maintenance/registration of more than one NIPT/NUIS by the same taxpayer with the status of Entrepreneur (Commercial Physical Person) and the submission of separate tax declarations for each of them shall be considered as an indication for tax avoidance and shall be subject to alternative tax assessment methods by the tax administration.

● Kalimi në regjistrin pasiv tatimor

Tatimpaguesit të cilët deklarojnë pezullim veprimtarie tregtare pranë QKB, do mund të kalojnë në regjistrin pasiv tatimor vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore.

Në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të publikohet dhe përditësohet mbi baza ditore lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv tatimor, transaksionet me të cilët janë të ndaluara. Nëse një tatimpagues aktiv hyn në transaksion shitblerje me një tatimpagues pasiv, do të zbatohen përkatësisht dënimet si më poshtë:

	Dënimet
Shitësi – tatimpagues aktiv	Gjobë 10,000 Lekë
Blerësi – tatimpagues pasiv	Detyrime të plota tatimore (TVSH, tatim fitim, etj.) + 100% gjobë (pra, transaksioni konsiderohet evazion tatimor)

	Dënimet
Shitësi – tatimpagues pasiv	Detyrime të plota tatimore (TVSH, tatim fitim, etj.) + 100% gjobë (pra, transaksioni konsiderohet evazion tatimor)
Blerësi – tatimpagues aktiv	Mosnjohje e TVSH-së së zbritshme të blerjes dhe mosnjohje e shpenzimit për efekte tatim fitimi

Më parë, përcaktoheshin shprehimisht dënime vetëm për personin e regjistruar në regjistrin pasiv dhe jo për palën tjetër aktive me të cilën hynte në transaksion.

● Çregjistrimi tatimor

Janë rishikuar procedurat për çregjistrimin e tatimpaguesve nga regjistri i administratës tatimore në varësi të institucionit ku ata tatimpagues duhet të paraqesin kërkesën për çregjistrim, konkretisht:

- a. pranë QKB,
- b. pranë Gjykatës (p.sh. organizatat jofitimprurëse), ose

● Transfer to the passive tax registry

Taxpayers that declare suspension of their commercial activity at the NBC, shall be transferred to the passive tax registry only after paying all tax liabilities.

The General Tax Directorate shall publish and update on a daily basis in its official website the list of taxpayers in the passive tax registry, with which any business transactions are prohibited. If an active taxpayer enters into a sale/purchase transaction with a passive taxpayer, both shall be subject to sanctions respectively as presented below:

	Sanctions
Seller – active taxpayer	Penalty 10,000 ALL
Buyer – passive taxpayer	Full tax liabilities (VAT, profit tax, etc.) + 100% penalty (the transaction is considered as tax evasion)

	Sanctions
Seller – passive taxpayer	Full tax liabilities (VAT, profit tax, etc.) + 100% penalty (the transaction is considered as tax evasion)
Buyer – active taxpayer	Non-recognition of credit of the input VAT on purchase and non-recognition of expense as deductible for profit tax purposes

Previously, there were sanctions specifically provided only for the passive taxpayer, not for the active one with which it entered into a transaction.

● Tax deregistration

The procedures for deregistration of taxpayers from the tax administration registry have been revised in accordance with the institution where taxpayers need to present their deregistration request, i.e. either:

- a. near the NBC,
- b. near the court (e.g. non-for-profit organizations), or

- c. pranë vetë administratës tatimore (p.sh. përfaqësuesit tatimorë, fermerët, etj.).

Janë përcaktuar afate lidhur me veprimet e administratës tatimore konkretisht, për verifikimin e situatës tatimore të tatimpaguesve, për ushtrimin e kontrollit pranë tyre si dhe për paraqitjen e kundërshtimeve ndaj çregjistrimit të tyre.

Kusht për çregjistrimin e tatimpaguesve nga regjistri i administratës tatimore, ndër të tjera, do të jetë edhe shlyerja e të gjitha detyrimeve tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim.

● Rregulla të përgjithshme anti-shmangie

Administrata tatimore do të ketë të drejtë të mos marrë parasysh veprime/transaksione që rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve e rrethanave e të cilat provohet se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor në kundërshtim me parimet e legjislacionit tatimor. Këto veprime/transaksione mund të jenë të tilla që:

- a. deformojnë parimet e ligjit tatimor;
- b. nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
- c. janë pa efekte ekonomike thelbësore;
- d. forma e tyre nuk reflekton thelbin ekonomik;
- e. përmbajnë elementë që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

- c. near the tax administration (e.g. tax representatives, farmers, etc.).

Deadlines have been set for the actions of the tax administration i.e. for the verification of the tax situation of the taxpayers, for conducting a tax audit on them and for presenting any objections against their deregistration.

A condition for the deregistration of taxpayers from the tax administration registry, among others, shall be the payment of all tax liabilities, including those arising in case the deregistration is made through the liquidation process.

● General anti-avoidance rules

The tax administration shall have the right to disregard actions/transactions that result fictive based on all facts and circumstances and which are proved as being undertaken for the purpose of obtaining a tax advantage in contradiction with the tax legislation principles. These actions/transactions may be such that:

- a. distort the principles of the tax legislation;
- b. are not based on the market value principle;
- c. are without substantial economic effects;
- d. their form does not reflect their economic substance;
- e. contain elements that aim the avoidance or reduction of tax liabilities.

Barrën e provës për të vërtetuar sa më lart do ta ketë kryesisht administrata tatimore. Në këto raste, administrata tatimore do ketë të drejtë të rikarakterizojë veprimin/transaksionin dhe të llogarisë detyrimin tatimor në bazë të metodave alternative të vlerësimit tatimor.

Mënyrat e zbatimit të metodave alternative për vlerësimin e transaksioneve do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

● **Pagesat e detyrimeve dhe kompensimet**

Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, do të përdoren fillimisht për të shlyer detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj tatimi, në qoftë se këto detyrime më të hershme nuk janë në proces apelimi apo gjykimi dhe nuk mbulohen nga ndonjë marrëveshje e pagesës me këste. Tepricat e pagesës pas shlyerjes së detyrimeve më të hershme, nëse ka, do të përdoren për të shlyer detyrimet aktuale të atij lloj tatimi.

Teprica kreditore e çdo lloj tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, do të përdoret automatikisht nga sistemi tatimor për kompensimin e detyrimeve tatimore të të njëjtit lloj tatimi.

● **Shuma minimale për vlerësim tatimor**

Administrata tatimore do të kryejë vlerësim tatimor vetëm nëse shuma e detyrimit tatimor të vlerësuar apo e tepricës kreditore të vlerësuar tejkalon vlerën minimale prej 1,000 Lekë (*më përpara, kjo vlerë minimale ishte 100 Lekë*).

The burden of proof to verify the above lies mainly with the tax administration. In these cases, the tax administration shall have the right to re-characterize the action/transaction and calculate the tax liability based on alternative tax assessment methods.

The modalities of application of alternative assessment methods for such transactions is expected to be determined by an instruction of the Minister of Finance.

● **Payment of liabilities and compensations**

Payments made for each tax, except for payments for social and health insurance contributions, shall be first used to settle earlier liabilities of the same type of tax in case such liabilities are not in appeal or court process and are not covered by any agreement of payment by instalments. The excess of payments after settlement of earlier liabilities, if any, shall be used to settle current liabilities of the same type of tax.

The credit balance of each type of tax, except for social and health insurance contributions, shall be automatically used by the tax system for the compensation of the liabilities of the same type of tax.

● **Minimum amount for tax assessment**

The tax administration shall make a tax assessment only in case the amount of the tax liability or the credit balance assessed exceeds the minimum amount of 1,000 ALL (*previously, this minimum amount was 100 ALL*).

- **Pagesa/garancia bankare e kamatëvonesave si kusht për ankimin e njoftim vlerësimit tatimor**

Pagesa ose vendosja në garanci bankare e kamatëvonesave (krahas vetë detyrimit tatimor të rivlerësuar) nuk do të jetë më një ndër kushtet për ankimin e një njoftim vlerësimi tatimor pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore. *Më parë, kamatëvonesat duhej të ishin detyrimisht pjesë e pagesës ose garancisë bankare.*

- **Penalizimi i deklarimit të pasaktë të tepricës kreditore**

Në rastin kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, do të kryhet një rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të deklaruar nga tatimpaguesi, ai do të penalizohet me gjobë 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore të rivlerësuar nga administrata tatimore. *Më parë, ulja e tepricës kreditore në rast kontrolli tatimor nuk ishte subjekt i asnjë gjobe.*

- **Reduktimi i gjobës për mos lëshim të faturës tatimore**

Në rast mos lëshimi të faturës tatimore, tatimpaguesi gjobitet me gjobë 100% të detyrimit tatimor të papaguar, përveç vetë tatimit dhe kamatëvonesave përkatëse. Megjithatë, në rast se tatimpaguesi do ta pranojë vlerësimin (pra, nuk do e ankimojë atë), atëherë gjoba do të reduktohet me 30% (pra, do të zbritet në 70%).

- **Dënimet për mos njoftimin e ndryshimeve të pronësisë sipas kërkesave të Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat"**

Dënimet për këto raste i kemi përmbledhur në seksionin "Ndryshimi i pronësisë dhe penalitetet për mos njoftimin e tij në bazë të Ligjit "Për procedurat tatimore"" në publikimin e mëparshëm lidhur me ndryshimet në Ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat".

- **Payment/bank guarantee over interest as a condition for appealing against a tax assessment notification**

Paying or putting under bank guarantee interests (in addition to the principal of the tax liabilities assessed) shall no longer be one of the conditions for the appeal against a tax assessment notification near the Tax Appeal Directorate or the Commission for Tax Appeals. *Previously, interests were necessarily part of the payment or bank guarantee.*

- **Penalization of the incorrect declaration of credit balance**

In the case that, as a result of a tax audit, it will be assessed a reduction of the credit balance declared by the taxpayer, the latter shall be subject to a penalty of 20% of the difference between the credit balance declared and the credit balance reassessed by the tax administration. *Previously, the reduction of the credit balance in case of a tax audit was not subject to any penalty.*

- **Reduction of penalty for non-issuance of the tax invoice**

In case of non-issuance of the tax invoice, the taxpayer is penalized with 100% of the unpaid tax liability, in addition to the tax liability and related interest. However, if the taxpayer accepts the assessment (i.e. does not appeal against it), the penalty shall be reduced by 30% (i.e. shall be reduced to 70%).

- **Penalties for not notifying changes in ownership in accordance with the requirements of the Law "On income tax"**

Penalties in these case have been summarized in the section "Change of ownership and penalties for not notifying it based on the Law "On tax procedures"" in the previous special tax news related to the changes in the Law "On income tax".

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.